

Në vitet tetëdhjetë të shekullit të kaluar, duke kërkuar nëpër biblioteka dhe arkiva të Francës çdo gjë që lidhej me Shqipërinë e shqiptarët, sidomos me gjuhën shqipe, pata fatin që të lexoj një studim të gjatë për arbëreshët e Italisë “Albanian in terra d’Otranto” që Princ Lui-Lysjen Bonoparti (Prince Louis-Lucien Bonaparte) e pat hartuar në anglisht dhe botuar në përmbledhjen *Ndërveprimet e Shoqërisë Filologjike* (*Transactions of the Philological Society*) në Londër, më 1884, ff. 492-501. Princi, e ripunoi shkrimin : shkoi sërish në treva të banuara nga arbëreshët e Italisë, bëri qortimet e duhura në terren, e plotësoi, e zgjeroi, e saktësoi; duke marrë parasysh edhe vërejtjet e bëra nga një gjuhëtar fare i ri polak, nga Jan Hanushi (Jan Hanusz) dhe e botoi të përmirësuar, dhe me dhjetë harta ngulimesh arbëreshe po në atë përmbledhje, po në Londër, më 1891 : “Albanian, Modern Greek, Gallo-Italic, Provençal, and Illyrian still in use (1889) as Linguistic Islands in the Neapolitan and Sicilian Provinces of Italy”¹.

Kjo që e papritur për mua që nuk e njihja Jan Hanusz-in dhe kërshëria m’u shtua edhe më shumë kur në ato të pakta shkrime që gjenden për jetën dhe veprën e tij, ai gjithandej quhej gjeni i gjuhësisë krahasuese të gjysmës së dytë të shekullit XIX. Ç’që ky gjeni që qe marrë edhe me arbërishten e Italisë? Ja kjo pyetje më shtyu të rrëmoj e gjurmoj më tej. Materiale për jetën dhe punën e tij si gjuhëtar ka fare pak² dhe kjo është e kuptueshme : vdiq nga meningjiti në moshën njëzetënëntëvjeçare!

Hartova një shkrim paraqitës për të, por nuk guxova ta botoj, se prisja të gjeja gjëra të reja për jetën dhe veprën e tij. Fati e solli që të gjej dy shkrime nekrologjike, të hartuara në polonisht, për gjuhëtarin djaloshtar, të shkruara nga profesorë dhe dashamirës të tij. Gjithashtu pata fatin të

1 (*Transactions of the Philological Society*, 1988-90. Published for the Society by Kegan Paul, Trench, Trübner & Co., Ltd., London, Karl I. Trübner, Strassburg. 1891, ff. 335-364.). Huluntuesi i përkushtuar Bejtullah Destani ka ribotuar shkrimet e Princ Lui-Lysjen Bonopartit në përmbledhjen *Albanian Dialects*, London, 2014, 80 f.; A. Përnaska, R. Përnaska, “Louis-Lucien Bonaparte, gjuhëtar dhe dialektolog krahasues”, *Hylli is Dritës*, 3, 2011, 93-113.

2 L. Leger, “L’albanais en Apulie”, *Mémoires de la Société de Linguistique de Paris*, VI, 1888, f. 263; Lucyan Malinowski, *Jan Hanusz*, botuar në Krakov, 1887, 8 f.; Adam Antoni Kryński *Jan Hanusz i jego prace*, Warszawa, 1888; Shihni edhe shkrimin e M. Karaš-it në *Polski Słownik Biograficzny* IX, Wrocław et alii. 1960-61, 284-285. Me shumë interes është autobiografia e shkruar nga vetë Hanusz-i. Ajo gjendet në Arkivin e Universitetit të Vjenës.

lexoj doktoratën që profesor Eqrem Çabej mbrojti në Vjenë më 1932, të përkthyer në mënyrë nga Ardian Klosi dhe me redaktore Brikena Çabejnë. Në këtë doktoratë citohen disa nga vërejtjet e bëra nga Jan Hanusz-i për disa pasaktësi në shkrimin e Princ Bonapartit³. Kohët e fundit, dhe Ina Arapi, Giovanni Belluscio, Monica Genesin e përmendin Hanusz-in në shkrimet e tyre⁴.

* * *

Jan Hanusz-i, gjuhëtar i shquar polak, profesor i Universitetit të Vjenës, i dalluar për njohjen e gjuhëve indoeuropiane, lindi më 13 qershor 1858 në Kolodziejówka të Galicisë lindore, sot qyteti i Ivano-Frankivsk-it në Ukrainë dhe vdiq më 26 korrik 1887 në Paris.⁵

Studimet e mesme i kreu në vitin 1877 në Stanisławów me rezultatin “Shkëlqyeshëm”. Për katër vite studioi në Universitetin e Krakovit (1877-81), në Fakultetin e Filozofisë, ku iu kushtua veçanërisht shkencave filologjike, sidomos atyre sllave me profesor Lucian Malinowski-n⁶ duke ndjekur ligjëratat e profesorëve Brandowski, Bratranek, Iskrzycki, Morawski, Straszewski, Szujski, Tarnowski.

Ende student, hartoi disa shkrime për historinë gjuhës polake dhe të dialekteve të saj, të cilat u botuan në përmbledhjet *Rozprawach Wydziału filologicznego* (Punime të departamentit të filologjisë) dhe në krejt vëllimin e dytë të *Sprawozdaniach Komisji językowej Akademii Umiejętności* (Raporte të Komisionit gjuhësor të Akademisë së Shkencave). Këto punime të rinisë së vet tërhoqën shumë shpejt vëmendjen e gjuhëtarëve dhe filologëve të mëdhenj të kohës, siç është rasti me profesor V. Jagić-in, me të cilin ka pasur letërkëmbim të shpeshtë dhe i cili i hap dyert e revistës së vet *Archiw filologii slowianskiej* (Arkiv i filologjisë sllave), ku shkruan me lëvdatat më të mëdha për Hanusz-in, djaloshin 22 vjeçar. Të tilla do të jenë edhe shkrimet e dijetarëve të njohur Brückner, Nehring, Malinowski, etj.

Njëherazi, vazhdon studimet për filologji klasike me profesor Kazimierz Morawski-n, të cilat i kreu me rezultate të shkëlqyera dhe, si ishte zakon

3 E. Çabej, *Studime italoshqiptare*, Përktheu nga origjinali gjermanisht dhe përgatiti për botim Ardian Klosi, Tiranë, 2016.

4 Shihni shkrimin e mirinformuar të Ina Arapit “Mësimi i gjuhës shqipe në Universitetin e Vjenës (fundi i shek. XIX - 2010)”, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, *Studime*, Revistë për studime filologjike, 20, 2013, Prishtinë, 2014; Giovanni Belluscio, Monica Genesin L'IDOMENEO Idomeneo Università del Salento, 19, 2015, ff. 221-243.

5 Lexuesi do të gjejë lëndë bibliografike në shkrimin e Adam Antoni Kryński-t “Jan Hanusz i jego prace”, *Prace Filologiczne*, Warszawa, 1888.

6 Lexuesi do të gjejë te shkrimi-broshurë i Lucyan Malinowski-t, *Jan Hanusz*, botuar në Krakov, 1887, 8 f. vlerësime të larta për studentin e vet gjenial, që e mban për “Nga të gjithë studentët e rregullt ishte më i rregullti, nga të gjithë studentët e zellshëm ishte më i zellshmi ... I pari në shkencë, nuk ishte i fundit në argëtimet me kolegët”.

atëhere, shkoi jashtë polonisë për të përkryer formimin e vet shkencor,

Studimin e sanskritishtes dhe gramatikës së krahasuar të gjuhëve indoeuropiane, e vazhdoi në Universitetin e Berlinit si student i rregullt i Fakultetit të Filozofisë pranë profesorëve Oldenberg, Joh. Schmidt dhe A. Weber.

Më 1881 fitoi bursën perandorake dhe shkoi në Lajpcig për të përsosur dijet për sanskritishten dhe gramatikën e krahasuar, nën drejtimin e profesorëve Georg Curtius, helenist në zë, Karl Brugmann, indoeuropianist dhe kryesues i gramatikanëve të rinj, August Leskien, baltosllavist dhe gramatikan i ri i madh, Ernst Windisch, specialist i njohur i gjuhëve kelte, të cilët e mëkuan me dashuri për gjuhësinë.

Ky formim i qëndrueshëm teorik i dha mundësi të mbrojë më 1882 në Lajpcig një doktoratë për theksin e emrit në gjuhën ukrainase, nën udhëheqjen shkencore të August Leskienit. Punimi u shpërblye me vlerësimin më të lartë : *summa cum laude* dhe mori gradën “Doktor i filozofisë”.

Më 1883 kthehet në Krakov, ku kalon me sukses provimin shtetëror në latinisht, greqisht të vjetër dhe polonisht para Komisionit të provimeve dhe u miratua si kandidat mësuesie për gjimnazet për mësimdhënie të gjuhës polake dhe të letërsisë e filologjisë klasike. Po atë vit zgjidhet anëtar i Komisionit gjuhësor të Akademisë së Shkencave në Krakov.

Më 1883, pas një viti e gjysmë qëndrimi në Lajpcig, shkon në Berlin për t’u thelluar në sanskritisht dhe në dialektet indiane pranë profesorëve Albrecht Weber, indianist i njohur, dhe Oldenburg. Ndoqi gjithashtu leksionet e profesor Johannes Schmidt-it, shtytës dhe nxitës i *Wellentheorie*-së (Teoria e valëve).

Në verën e vitit 1884 shkon në Vjenë për të ndjekur ligjëratat e profesorëve Miklosich, Georg Bühler (indianist) dhe Fridrich Müller dhe përgatit një tezë për kërkimin e gradës shkencore Doktor shteti me titull “Shtrirja e ngadalshme e temave më -n- në lakimin e indishtes së lashtë”, falë mbrojtjes së të cilës u bë *veniam legendi* (u habilitua) i Universitetit të Vjenës për sanskritisht dhe gramatikë krahasuese të gjuhëve indoeuropiane.

Në raportin e Komisionit të docenturës, ndër të tjera shkruhet : “Sa i përket studimit *Ueber das allmälige Umsichgreifen der n-Declination im Altindischen* (Mbi përhapjen shkallë-shkallë të lakimit me n- në indishten e vjetër), që është hartuar posaçërisht për marrjen e docenturës, mund të thuhet sipas vlerësimit të të dy specialistëve, prof. Bühler dhe F. Müller, se dëshmon njohuri të thella dhe një njohje të admirueshme të letërsisë vedike. Përveç kësaj është shkruar qartë dhe në mënyrë të kuptueshme”.

Në autobiografinë e vet të hartuar në vjenë më 19.09.1884 njofton se “Deri më tash kam hartuar mjaft punime për filologjinë klasike dhe atë sllave, si dhe për gramatikën e krahasuar të gjuhëve indoeuropiane, që kanë dalë kryesisht në serinë e botimeve të Akademisë të Shkencave të

Krakovit dhe në “Archiv für slavische Philologie”. “Në Berlin kam punuar për dorëshkrimet në prākrit të një teksti xhaina, të cilin dëshiroj ta botoj. Përveç këtyre në Krakov kam mbledhur shumë material për fjalorin e polonishtes së vjetër, botimi i të cilit po përgatitet nga Akademia e atjeshme e Shkencave. Po kështu kam përgatitur së bashku me profesorin Bobrzyński botimin e shumë dokumentave të polonishtes së vjetër.”⁷

Më 1885 ligjëron vullnetarisht, pa rrogë, në Universitetin e Vjenës për lituanishten dhe për gjuhët kelte.

Ndërkohë, më 1885, studion armenishten dhe shkruan veprën e vet më të famshme në dy vëllime (1885, 1888) për emrat me prejardhje armene në polonisht.

* * *

Në fillim të vitit 1887, me një bursë të Akademisë së Shkencave për profesorë të habilituar, shkon përsëri në Itali, në Francë dhe në Angli. Pas një qëndrimi të shkurtër në Romë, shkon në Kalabri, ku, nga fshati në fshat, studioi të folmet shqiptare dhe sllave dhe mbledhi rrëfenja dhe këngë popullore. Albanologët e sotëm polakë dhe austriakë duhet dhe mund të bëjnë kërkime të mëtejshme për të gjetur dhe trajtuar shënimet, këngët dhe materiale të tjera që Hanusz-i mbajti e mbledhi në fshatrat arbëreshe të Italisë. Hanusz-i shkruan dhe boton në revistën *Mémoires de la Société de Linguistique de Paris*, VI, 1888, f. 267 “L’albanais en Apulie” ku dëshmon : “Shumë tekste të tjera në këtë dialekt dhe në dialekte të tjera, si edhe një studim gramatikor, do të botohen në *Comptes rendus de l’Académie des sciences de Cracovie*”. Një pjesë e qenësishme e shkrimeve të djaloshtarit polak janë botuar nëpër revista gjermane, çeke dhe polake (*Archiv für Slavische Philologie*, *Ateneum* e Varshavës, *Mémoires de l’Académie Polonaise de Cracovie*, *Sbornik Slovanský* e Pragës, etj.).

Për këta arritje të rëndësishme në punën e vet ai mori në vitin 1887 bursën e madhe shkencore Sniadecki të Akademisë së Shkencave (prej Fondacionit Galezowski) dhe shkoi në Itali, Francë dhe Angli për të hulumtuar veçanërisht shqipen dhe keltishten. Në Itali u mor sidomos me dialektet e pjesës më të madhe të vendbanimeve shqiptare, greke dhe sllave⁸.

* * *

Më 1887 vjen në Paris për të përfituar nga bibliotekat e saj të pasura për t’i përkapur edhe më mirë gjuhët kelte. Më 25 qershor 1887 bëhet anëtar i Shoqatës Gjuhësore të Parisit vetëm një muaj para vdekjes, më 26 korrik 1887. Sheston të shkojë për hulumtime në terren në Vendin e Galëve, por

7 Ina Arapi, “Mësimi i gjuhës shqipe në Universitetin e Vjenës (fundi i shek. XIX - 2010)”, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, *Studime*, Revistë për studime filologjike, 20, 2013, Prishtinë, 2014.

8 J. Hanusz, “L’albanais en Apulie”, *Mémoires de la Société de Linguistique de Paris*, VI, 1888, f. 264.

sëmuret nga tifoja që ishte përhapur ndërkohë dhe vdes duke qëndruar vetëm gjashtë javë në Paris, ku edhe u varros.

Vdekja e papritur e pengoi atë të merrte drejtimin e katedrës së sanskritishtes dhe gramatikës së krahasuar në Universitetin Jagielloński.

* * *

Jan Hanusz-i pati fatin e madh të njohë drejtpërsëdrejti rrymat gjuhësore që përhapeshin prej afërsisht dhjetë vitesh në perëndim, sidomos në botën gjermanike dhe që arritën kulmin me Shkollën e gramatikanëve të rinj (*Junggramatische Schule*), ithtar i flaktë dhe përhapës i së cilës u bë qysh në fillimet e saja.

Në vitet '70 të shek. XIX në Lajpcig u krijua një grup gjuhëtarësh, të cilët fillimisht u cilësuan me ironi si "Gramatikanët e Rinj" nga gjenerata më e vjetër, që i konsideronte pa përvojë dhe radikalë. Shihet këtu mosbesimi që shfaqet në fillim në Universitetin e Vjenës ndaj njëres prej rrymave më të suksesshme të gjuhësisë së krahasuar dhe përfaqësuesve të saj, të cilët u morën me studimin e historisë së gjuhëve indoeuropiane dhe arritën rezultate të shquara duke u bazuar sidomos në postulatit e veprimit absolut dhe pa përjashtime të ligjeve fonetike. Duket gjithashtu qartë se ndaj kolegëve të tij Hanusz,-i ishte kandidati më i plotësuar për nga formimi për këtë fushë studimesh.

Ende student në Krakov, ai ishte i bindur se studimet gjuhësore duhet të bazohen mbi hetimin e thelluar të dialekteve dhe të folmeve të gjalla, ndaj duhen mësuar sa më shumë gjuhë. Është pikërisht kjo frymë hetimi që e çoi, ndër të tjera, të merrej edhe me shqipen e ta mësonte edhe atë

Synimet dhe planet e veta të kërkimeve shkencore gjuhësore tejet ambicioze, ndër të tjera, më kryesore, parashikon hartimin e : 1. *Gramatikë elementare e gjuhës sanskrite sipas manualit të prof. Bühler* 2. *Hyrje në Rig-veda*. Një vështrim i përgjithshëm i letërsisë vedike me shënimet përkatëse historike-letrare, më gjërat më të rëndësishme për gjuhën dhe metrikën e vedave, me shpjegim të disa hymneve të zgjedhura të Rigvedës 3. *Gramatikë e krahasuar e gjuhëve indoeuropiane*. "Në trajtimin e fonetikës dhe të gramatikës dua t'i përfshij të gjitha grupet gjuhësore indoeuropiane njëherësh; pra nuk dua të ofroj një gramatikë paralelesh, por një gramatikë të vërtetë krahasuese. Për krahasim nuk duhet të merren vetëm përfaqësueset më të vjetra të gjuhëve indoeuropiane, por, atje ku është e nevojshme, edhe dialektet indoeuropiane moderne".

Siç duket, synimi për t'u marrë me studimin edhe të gjuhës shqipe erdhi si pasojë e këtij qëndrimi të dr. Hanusz se në krahasim duhet të përfshihen edhe dialekte të tjera indoeuropiane dhe jo vetëm ato më të vjetrat.

Në planet e veta shkencore bënin pjesë gjithashtu edhe hartimi e botimi i një 4. *Gramatikë e lituanishtes*. Në sqarimin e formave gjuhësore të veçanta do të marr parasysh jo vetëm letishten dhe prusishten e vjetër, por

edhe sllavishten, sanskritishten dhe, po të jetë e nevojshme, edhe gjuhë të tjera indoeuropiane 5. *Gramatikë e krahasuar e gjuhëve greke dhe latine*. Do të jetë fjala në radhë të parë për raportin e të folmeve jonike-atike me ato latine, por po të jetë e nevojshme, do të merren parasysh edhe dialekte të tjera greke dhe italiane, si dhe sanskritishtja e disa gjuhë të tjera indogjermane 6. *Skicë e historisë së letërsisë indiane*. Një vështrim i shkurtër i letërsisë vedike dhe asaj klasike në sanskritisht, si dhe diçka për tekstet Pāli dhe Xhaina⁹. Dhe gjuhëtari ynë nuk i kishte mbushur të tridhjetat!

Spektri i gjerë i interesave të tij shkencore përfshinte fusha të ndryshme të gjuhësisë indoeuropiane, prej filologjisë në kuptimin e ngushtë deri te hulumtimi i dialekteve dhe ekspeditat në terren. Edhe çështjet teorike nuk i linte mënjane.

Të gjitha këto të dhëna dëshmojnë se ekzistonin premiset për një karrierë të shkëlqyer të docentit të ri, por vdekja e rrëmbeu fare të ri, 29 vjeç

Jan Hanusz-i dhe gjuha shqipe

Nxënës i jashtzakonshëm i gjuhëtarëve të mëdhenj të gjysmës së dytë të shekullit XIX (Leskien, Brugmann, Windisch, Jagić, etj.), doktor i filozofisë dhe docent i sanskritishtes i Universitetit të Vjenës, Jan Hanusz-i shkrimin e fundit të jetës së vet, pak kohë para se të vdiste, ia kushtoi gjuhës shqipe. Ai u botua në revistën *Mémoires de la Société de Linguistique de Paris*, VI, 1988, ff. 263-267 me titullin “L’Albanais en Apulie”, në të cilin na siguron se : “Sa u përket veçorive të tjera të këtij dialekti (San-Marzano R. P.) ne do t’i trajtojmë sistematikisht gjetiu, në një studim tërësor për dialektet shqiptare të Italisë së Jugut”.¹⁰

Në interesat e veta shkencore, përfshiheshin të gjitha gjuhët indoeuropiane, veçanërisht ato më pak të studiuarat si shqipja, lituanishtja, dialektet kelte dhe armenishtja.

Sipas L. Leger-it, ai fliste lirshëm lituanisht dhe shqip¹¹.

Shkrimi “L’albanais en Apulie” ka të bëjë kryesisht me të folmen arbëreshe të San-Marzano-s, që, sipas Hanusz-it, ishte i vetmi ngulim arbëresh i Puljes, ku të gjithë flisnin ende shqip, kurse në fshatrat e tjera fqinje me prejardhje nga Shqipëria, gjuha shqipe ishte bjerë dhe nuk flitej më shqip, por italisht. Shkrimi i Hanusz-it synon të qortojë disa pasaktësi

9 Ina Arapi, “Mësimi i gjuhës shqipe në Universitetin e Vjenës (fundi i shek. XIX - 2010)”, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, *Studime*, Revistë për studime filologjike, 20, 2013, Prishtinë, 2014.

10 J. Hanusz, “L’albanais en Apulie”, *Mémoires de la Société de Linguistique de Paris*, VI, 1888, f. 265.

11 L. Leger, “L’albanais en Apulie”, *Mémoires de la Société de Linguistique de Paris*, VI, 1888, f. 263.

gjuhësore, kryesisht në fonetikë, që ai vëren në shkrimin e princ Louis-Lucien Bonaparte-s. Për më tepër, si gjuhëtar edhe i terrenit, kishte bërë, pak kohë më parë, hulumtime diektologjike në shumicën e ngulimeve arbëreshe të Italisë jugore, ndaj bën disa qortime që pjesërisht plotësojnë, pjesërisht qortojnë lëndën e botuar nga princi.

Këtu më poshtë lexuesit i jepet teksti i plotë në origjinal, në frëngjisht, i Jan Hanusz-it. Krahاسimi i dy teksteve, i atij të princit dhe atij të Hanusz-it bëhet lehtë, dhe është më së fortë punë e dialektologëve arbëreshë dhe e historianëve të gjuhës shqipe të thonë si është e vërteta, ndaj nuk po ndalemi më tej.

Si e kemi theksuar më sipër, autori ynë premton se do të trajtojë sistematikisht veçanti të tjera të të folmes së San-Marzano-s në një studim të përgjithshëm për të folmet e arbëreshëve të Italisë jugore. Deri më sot nuk kemi rënë në gjurmë të këtij studimi të lënë ndoshta si dorëshkrim.

Po e mbyllim shkrimin tonë me një vrojtim tejet interesant të Hanusz-it për historinë e gjuhës shqipe : në këtë të folme, numërorët, duke filluar nga tridhjeta, kanë në bazë numërorin «dhjetë» : 30, *tre-djèt* ; 40, *kater-djèt* ; 50, *pes-djèt* ; 60, *gàšt-djèt*, etc. Në të folme të tjera, dhjetat tek formohen me numërorin «dhjetë», kurse dhjetat çift me numërorin «njëzet» : 30, *tre-djèt* ; 40, *di-zèt* ; 50, *pes-djèt* ose *dizèt-djèt* ; 60, *trizèt*, etc.

* * *

Ja shkrimi “L’albanais en Apulie”, i botuar në *Mémoires de la Société de Linguistique de Paris*, VI, 1888, f. 263-267.

L’ALBANAIS EN APULIE.

Le prince Lucien Bonaparte a publié, dans les *Transactions of the Philological Society* (Londres, 1884), p. 692-501, un article intitulé *Albanian in Terra d’Otranto*. Dans l’introduction, l’auteur rectifie les notices données jusqu’à présent sur les colonies albanaises et grecques de l’Italie du sud. Puis il nous donne un recueil de trente-huit mots, trois phrases et une petite chanson, recueillie pour lui à Saint-Marzano par P. de Vincentiis. Saint-Marzano, situé à environ 20 kilomètres de Tarente, est la seule des colonies albanaises d’Apulie où tout le monde parle encore aujourd’hui l’albanais. Dans les autres villages voisins d’origine albanaise, on ne parle aujourd’hui que l’italien. Le prince Bonaparte a transcrit de l’orthographe italienne en orthographe phonétique les matériaux qu’on lui a envoyés, et il a remplacé la traduction italienne par une traduction anglaise. Il avoue même que “the song and the phrases appear in a more corrupted form than the isolated words of the list”. Mais, comme les « mots isolés » ne sont pas toujours exactement écrits et que leur nombre est très petit, ils ne peuvent donner une idée nette des particularités de ce dialecte. Ayant visité, il y a

peu de temps, la plupart des colonies albanaises de l'Italie du sud, je vais donner ici quelques notes qui serviront en partie à compléter, en partie à corriger les matériaux publiés par le prince Bonaparte.

Parmi les particularités phonétiques qui caractérisent le dialecte de Saint-Marzano, il faut mentionner surtout que :

1° La spirante sonore interdentale δ est remplacée, au commencement des mots par t , à l'intérieur et à la fin des mots par d ; ex. : α) *tē* « terre », *tēmb* « dent », *tēndr* « gendre » ; dans d'autres dialectes : *δē*, *δēmb*, *δēndr* ; — β) *dàrd-a* « la poire », *ūd* « rue », *mad* « grand », *bard* « blanc », et ailleurs : *dàrd-a*, *ūd*, *mad*, *barδ*.

2 La spirante sonore γ est remplacée au commencement des mots, comme dans plusieurs autres dialectes, par h (rarement par f), à l'intérieur et à la fin des mots par g ; ex. : α) *hōr* « ville », *hēn* « lune », *hēkur* « fer », *u hāñ* « je mange », *hap* « ouvrez ! », *hīr* « entrez ! », dans plusieurs villages de Calabre (S^t-Sophia d'Epiro, S^t-Demetrio Corone, Macchia, Vacarizzo, Cosmo-Strigàr, S^t Giorgio-Mbuzàt) : *γōr*, *γēngēz*, *γēkur*, *u γā*, *γap!* *γīr!* mais *γūnd* « nez », *γūδēr* « ail », se prononcent à Saint-Marzano *fund*, *fūder*, ailleurs *hund*, *hūδēr* ; — β) *ù šōg* « je vois », *ju nìgni* « vous savez » ; ailleurs *ù šōγ*, *šōχ*, *šōh*, *šō* ; *ju nìyni*, *nìhni*.

3° La spirante sourde interdentale ϑ est souvent remplacée par h ou f ; ex. : *u hom* « je parle », *hik* et *fik* « couteau », calabr. *u θom*, *θik*, de même en Basilicate et Molise ; à côté j'ai entendu : *θiña* « je simulais », *θròn* « banc », *ùθul* « vinaigre », *giθ* « tout, entier », *bàθ* « fève » ; mais, chez le prince Bonaparte, on lit : *fīnja*, *baf*.

4° Les groupes phonétiques *pj*, *bj*, *ff* deviennent, comme dans plusieurs autres dialectes, *plj*, *blj*, *flj* ; ex. : *pljòt* « plein », *u bljèñ* « j'achète », *u fljeñ* « je dors » ; de même dans la Basilicate et dans les villages limitrophes de la Calabre, Civita, Plataci, Farneta et Castroreggio ; d'ailleurs en Calabre : *pjòt*, *u bjèñ*, *u ffōⁿ*. Naturellement il faut regarder *lj* comme un *l* mouillé.

5° Les groupes phonétiques *kj*, *gj* deviennent *klj*, *glj* ; ex. : *kljìš* « église », *u kljèva* « j'étais », *gljìšt* « doigt », *gljùg* « langue » ; dans la plupart des colonies de Calabre : *kjìš*, *u kjèva*, *gjìšt*, *gjùγ*. D'ailleurs, on parle dans les villages que je viens de nommer, dans la Basilicate et dans la Molise, comme à Saint-Marzano. À proprement parler, nous n'avons pas ici de groupes phonétiques *kj*, *gj*, mais seulement les palatales *kj*, *gj*.

6° Entre *m-r* apparaît ordinairement un *b* dissimilant ; ex. : *ēmbër* « nom », *zēmbër* « cœur » ; dans d'autres dialectes : *ēmr*, *zēmr*.

Quant aux autres particularités de ce dialecte, nous les traiterons systématiquement ailleurs, dans une étude d'ensemble sur les dialectes albanais de l'Italie du sud. Qu'il suffise de noter ceci : que les noms de nombre, à partir de trente, se forment avec le nombre « dix » : 30, *tre-djèt* ; 40, *kater-djèt* ; 50, *pes-djèt* ; 60, *gàšt-djèt*, etc. Dans d'autres dialectes, les

dizaines impaires se forment avec le nombre « dix », les dizaines paires avec le nombre « vingt » : 30, *tre-djèt* ; 40, *di-zèt* ; 50, *pes-djèt* ou *dizèt-djèt* ; 60, *trizèt*, etc.

J'ai entendu, sous une forme un peu différente de celle que donne le prince Bonaparte, la *Romance of the Betrothed*. Je me permets de la donner ici :

*ðĩña, sè ngę te dèna, e ìši panzàn,
Kundzëdrò ti zëmbra ìmę.
Pęrpàra tę škòda náj me bùz,
Kljëve pę greštëra, čę ngę te vrëta.
U kàm e ljen, ku iše mir dèña,
Tę t' mår ti, zëmbra ìme.
Nanì prìremi ne dia, se ne døgemi,
Šòkje mę ka tę jèsęš, čę dò Krišti.*

TRADUCTION.

Je simulais que je ne t'aimais pas, et c'était un mensonge :

Tu as pénétré mon cœur.

Devant toi je marchais un peu fâché¹²

C'était pour les hommes¹³ que je ne t'ai pas regardée.

Je l'ai laissé où il était, l'amour¹⁴,

Pour te prendre, ô mon cœur.

Alors tournons-nous tous deux, si nous nous aimons,

Afin que tu sois ma femme, ce que Dieu veut.

Peut-être pourrait-on, à l'aide de ce texte et de celui que le prince Bonaparte a publié, restituer la véritable forme de cette chanson.

À propos des « Isolated Albanian words », je puis noter ici que j'ai entendu : *Bekùami* « le Christ », proprement : « bénit », *Bekùamja* « Notre Dame », proprement : « bénite ». Au lieu de 4. *brem* « soir », j'ai entendu seulement *mbrëm* ; au lieu de 16. *kampàra* « cloche » seulement *kumbòr* ou *kęmbòr*. Dans 26. *mma* « mère », le premier *m* fait une syllabe ; aussi on écrivait plus exactement *męma*. 32. *Rusja* « la fiancée » n'est évidemment qu'une faute d'écriture pour *Nusja* ; 33. *zìmbra* serait écrit plus régulièrement *zëmbra*. Le mot *štępija* paraît être plus ancien que *špija* des autres dialectes albanais de l'Italie du sud. D'ailleurs, il y a dans ce dialecte de Saint-Marzano plusieurs mots qui sont employés rarement dans les autres dialectes ; ex. : *maffërja* « couteau », évidemment du grec μάχαίρα ; *u kušiloń* « je parle » : *kęšilommi nd gljùg jònni* « parlons dans notre langue ». C'est pourquoi les Albanais de Saint-Marzano comprennent difficilement l'albanais de Calabre.

12 Littéralement « un peu avec la lèvre », peut-être comme en français « faire la moue ».

13 *Greštëra*, « les Christ »

14 Proprement « bonne volonté ».

En terminant, je vais donner encore un *sunèt* « sonetto » (les autres dialectes disent *vjèrš* « vers »):

*Dìe mbrèmb škòda è ngə tɛ pèu,
E ti bùkɛra ime, nd' argalī,
Ngà kopanè, č'ipné nd' ajò kàš,
Me škandogše zèmbra pɛ ti.*

TRADUCTION.

Hier soir j'ai passé et je ne t'ai pas vue,
Et toi, ma beauté, au métier à tisser,
Chaque coup que tu donnais dans cette caisse¹⁵
M'a brisé le cœur pour toi.

Encore une improvisation :

*Dèna tɛ dīna, čɛ kà te bɛše,
Me kèt tɛ škruòr, čɛ jè tɛ bèn.*

Je voudrais savoir ce que tu dois faire
Avec cette écriture que tu es en train de faire.

Plusieurs autres textes en ce dialecte comme en d'autres dialectes, ainsi qu'une étude grammaticale, seront publiés dans les *Comptes rendus de l'Académie des sciences de Cracovie*.

Jean HANUSZ.

Abstract

Remarkable Polish linguist Jan Hanusz (1858-1887) found time in his short life to study the dialects of Arbëresh in Italy. He also published an essay by the title "L'albanais en Apulie" in *Mémoires de la Société de Linguistique de Paris*. In his essay he recounts his visit to the Arbëresh villages in southern Italy and that he intends to shortly publish a comprehensive study on the dialects of these Arbëresh settlements. Unfortunately, the study was never published, as the linguist died young. Possibly Hanusz left detailed notes and other documents concerning the Italian Arbëresh now scattered around archives in Warsaw, Krakow, Vienna and perhaps Berlin as well.

¹⁵ Une partie du métier à tisser.